

VENDIM
Nr. 259, datë 27.4.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI I ZONËS SË MBROJTUR NGA LUMI OSUM DHE RIJETËZIMI I FASADAVE TË QENDRËS SË QYTETIT URA VAJGURORE, BASHKIA DIMAL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i zonës së mbrojtur nga lumi Osum dhe rijetëzimi i fasadave të qendrës së qytetit Ura Vajgurore, Bashkia Dimal”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Dimal.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “truell”, me një vlerë të përgjithshme prej 604 285.5 (gjashtëqind e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 604 285.5 (gjashtëqind e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë pesë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Dimal.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Dimal.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Dimal.

8. Bashkia Dimal kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Dimal.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Dimal për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Dimal për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Dimal, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “REHABILITIMI I ZONËS SË MBROJTUR NGA LUMI OSUM DHE RIJETËZIMI I FASADAVE TË QENDRËS SË QYTETIT URA VAJGURORE”

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKARE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM							SHËNIME (Kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	ARË		TRUALL			VLERA TOTALE (lek)		
														Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)		Vlera (lek)	
	A	B	C	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	Y	Z
	Anila	Fatmir	Majuni																		Konfirmuar nga ASHK-ja, mbi këtë pasuri ka dy ndërtime të paligjshme
	Armando	Fatmir	Majuni																		
	Azis	Metin	Ruli																		
	Fatmir	Irfan	Majuni																		
	Fatmira	Ali	Selenica																		
1	Graciana	Metin	Ruli	Urë Vajguore	3682	1/502	Truall	3500		3500		6	203			0	231.7	2375	550,287.5	550,287.5	
	Kujtim	Ali	Kuçi																		
	Luan	Ali	Kuçi																		
	Mirjana	Metin	Ruli																		
	Qamile	Ali	Kuçi																		
	Zhaneta	Ali	Çakmaxhajian																		
2	Afrim Xheladin Lybesha Eglantina Adem Lybesha			Urë Vajguore	3682	1/390	Arë+ Truall	960	960	200	106	1	6	188	203	38164	-	0	-	38,164.0	Konfirmuar nga ASHK-ja. Më datë 10.7.2020 është kryer rivlerësimi i pasurisë në shumën 3,922,000. Ky rivlerësim është i vlefshëm deri në kryerjen e një transaksioni mbi pasurinë e rivlerësuar, përveç trashëgimisë ligjore, në përputhje me udhëzimin nr. 29, datë 30.7.2018. Lloji i pasurisë arë + truall R.009, 21.6.2005 lëshohet certifikatë datë 21.6.2005. Me urdhrin nr. 11 u bë korrigjimi i referencës. Me referencë 1897/671
3	Saimir	Zeni	Guraj	Urë Vajguore	3682	1/388	Arë	765	765			1	4	78	203	15834	-	0	-	15,834.0	Konfirmuar nga ASHK-ja
SHUMA																53,998			550,287.5	604,285.5	